

VENDIM
Nr. 68, datë 6.2.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 769, DATË 15.7.2009, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË
PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE (AMSHC)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr.10093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur vendimit nr. 769, datë 15.7.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)”, të ndryshuar, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA Nr. 1

STRUKTURA E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE



ORGANIKA E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

	POZICIONI	KLASA	NUMRI
1	DREJTOR EKZEKUTIV	I-3	1
	SEKRETAR		1
2	SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PROGRAMEVE TË GRANTEVE DHE ZHVILLIMIT RAJONAL		3
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-2	1
	SPECIALIST	IV-2	2
3	SEKTORI I ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE, BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR DHE KOMUNIKIMIT		4
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-2	1
	SPECIALIST	IV-2	3
4	NJËSIA PËR SEKRETARIATIN E KSHC-SË		3
	SPECIALIST (PËR MARRËDHËNIET ME JASHTË)	IV-2	1
	SPECIALIST (PËR DRAFTIM DHE PËRGATITJE MATERIALESH)	IV-2	1
	SPECIALIST (ARKIVIM DHE KOMUNIKIM)	IV-2	1

Faqe 1 nga 2

	POZICIONI	KLASA	NUMRI
5	SEKTORI I FINANCËS DHE KONTROLLI I BRENDSHËM		4
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-2	1
	INSPEKTOR	IV-1	1
	SPECIALIST	IV-2	1
	MAGAZINIER		1
PUNONJËS GJITHSEJ			16

Faqe 2 nga 2